



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

---

## DRAFT-RREGULLORE PËR TRANSPARENCË KOMUNALE

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Draft-Rregulloren për Transparencë Komunale mbajtur më: **10.04.2025**, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora **11:00**.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit
6. Jeta Balaj, Zyra për Informim

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Drejtori i Administratës, z. Arben Kabashi.

**Drejtori, z. Arben Kabashi** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Draft-Rregulloren për Transparencë Komunale dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

### R E N D D I T E

1. Njoftimi për Draft-Rregulloren për Transparencë Komunale,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Konsultimi publik u organizua nga Komuna e Istogut me qëllim të prezantimit dhe diskutimit të Draft-Rregullores për Transparencë Komunale. Takimi u mbajt me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve të interesuar.

Takimi u hap nga Drejtori i Administratës dhe zyrtari i zyrës për informim publik, te cilët shpjeguan qëllimin e draft-rregullores dhe rëndësinë e saj për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe qasjes së qytetarëve në dokumente dhe vendime komunale.

Gjatë prezantimit, u shpjeguan nenet kryesore të draft-rregullores, duke u ndalur në procedurat për publikimin e vendimeve, njoftimeve publike, kontratave dhe informatave të tjera me interes publik. U theksua se rregullorja synon të forcojë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve komunale dhe të përmirësojë komunikimin institucional.

Pjesëmarrësit dhanë komente dhe sugjerime konkrete, duke kërkuar që informacionet të publikohen në kohë reale, të jenë të qarta dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët. U diskutua gjithashtu roli i mediave lokale dhe platformave digjitale në shpërndarjen e informacionit.

Në përfundim të konsultimit, përfaqësuesit komunalë falënderuan pjesëmarrësit për kontributin e dhënë dhe u zotuan se komentet dhe rekomandimet e pranuar do të shqyrtohen dhe do të përfshihen, aty ku është e mundur, në versionin final të rregullores.

Faleminderit shumë!

Procesmbajtës:  
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

